

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MATERIALE NDËRTIMI”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):  
44110000-4; 44111200-3; 14211000-3; 14212310-6; 14212430-3; 44921210-7;44921200-4;  
44531700-8.**

---

**VLERA E FONDIT LIMIT PËR OBJEKTIN: “BLERJE MATERIALE NDËRTIMI ”**

**Fondi limit: “Blerje materiale ndërtimi”: 4,959,358.00 (katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Sherbimeve Funerale ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **në një vlerë jo më të vogël se 40% (vlera 1,983,743.2 lekë) e fondit limit**. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: **(2021, 2022)** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore si dhe raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009. Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe neni 43 pika 2/c, pika 3 e pika 4, dhe neni 55 pika 4 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas kapacitetit ekonomik dhe financiar të përcaktuara në pikën 2.2 i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse ofertuesit zotërojnë kapacitetet financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Vlera e xhiros vjetore të kërkuar është përcaktuar në masën jo më të vogël se **se 40% (vlera 1,983,743.2 lekë)** e fondit limit, vlerë e cila është brenda kufijve të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të V.K.M, sipas së cilës vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë, nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar. Kjo vlerë është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

---

## **3. Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, I ndryshuar, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.**

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore

për vitin 2023, të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari Biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

---

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 20 % (vlera 991,871.6 lekë) e fondit limit.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Operatorët ekonomikë si dëshmi për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 55 pika 4/b e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr.1797/1prot, datë 10.03.2022. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% (vlera

**991,871.6 lekë**) të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të **paktën 1(një) mjete transporti** kamion vetëshkarkues me kapacitet mbi 3.5 ton për transportimin e mallrave sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Mjetet të jenë në pronësi/qera/huapërdorje shoqëruar me dokumentet:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikatë për transport mallrash (e vlefshme), çertifikatë e kontrollit teknik, (i vlefshëm); siguracion mjeti, (i vlefshëm).
- b) Për mjetet e deklaruara me qera/huapërdorje duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë/huapërdorjes e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikatë e kontrollit teknik, (i vlefshëm); çertifikatë për transport mallrash, (i vlefshëm), siguracion mjeti (i vlefshëm);

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë stafin që disponon në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 8. Në zbatim të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi:** : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Ligjin Nr. 8308, datë 18/03/1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), Vendimit Nr.325, datë 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtarë, të caktuara për këto operator”; Udhëzimin Nr.15, datë 24/07/2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjete dhe pajisje teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ky kriter është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambientet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

3. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës për realizimin e objektit të prokurimit, duhet të kenë minimalisht të punësuar 3 vetë, përkatësisht 1 (një) shofer dhe 2 (dy) punëtor ngarkim shkarkimi. Për këtë kriter operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Qershor-Gusht 2023.

- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor-Gusht 2023.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë stafin që disponon në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, shtojca 8. Në zbatim të nenit 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion fuqi punëtore për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Arsyeja e përcaktimit të numrit të punëtorëve: Për vendosjen e këtij kriteri përveç sasisë dhe grafikut të lëvrimit janë marrë në konsideratë edhe vendi ku do të kryhet furnizimi dhe procesi i ngarkim shkarkimit të mallrave. Një thes me çimento do një punëtor mbi kamion dhe një tjetër në tokë, për transport në vendin e magazinimit të saj. Kjo është praktika e ndjekur deri tani në terren nga firmat furnizuese në kontrata të mëparshme.

4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratë që furnizimi do të bëhet me mjetet dhe shpenzimet e operatorit ekonomik fitues sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që marrin përsipër realizimin e objektit të kontratës, nëpërmjet transportit me mjetet dhe shpenzimet e tyre, sipas grafikut të lëvrimit të vendosur nga autoriteti kontraktor.

5. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatë të vlefshme të cilësisë, ku të përfshijë objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- S SH EN ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
- S SH EN ISO 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;
- S SH EN ISO 45001: 2018 mbi “Sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë” ose ekuivalente / të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë

Çertifikatat e kërkuara më sipër, janë vlerësuar se lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës, dhe konkretisht:

- Çertifikata S SH EN ISO 9001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme, është një provë dhe garanci se operatori ekonomik ofertues ka një system të menaxhimit të cilësisë, nëpërmjet së cilës demonstron aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte, që plotësojnë standartet më të larta të cilësisë.

- Çertifikata S SH EN ISO 14001: 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/ të barazvlefshme, është vendosur si kriter duke marrë në konsideratë faktin që: Standarti ISO 14001 Sistemi i Menaxhimit Mjedisor është një sistem sistematik dhe i orientuar drejt procesit të menaxhimit të cilësisë për të kontrolluar impaktet e rëndësishme të aktiviteteve të biznesit në mjedis, dhe në rastin konkret duke qenë se objekt i prokurimit janë materiale ndërtimi inerte, si dhe duke vlerësuar faktin që këto materiale do të përdoren për kryerjen e punimeve në ambjente publike, paisja me këtë standart është e rëndësishme sepse siguron që këto mallra do të prokurohen nga OE, që i plotësojnë kërkesat minimale të ndikimit në mjedis.

- Çertifikata S SH EN ISO 45001: 2018 mbi “Sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë” ose ekuivalente / të barazvlefshme është një certifikatë, e cila ofron një kuadër për menaxhimin efikas të shëndetit dhe sigurisë në punë, përfshirë të gjitha aspektet e menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore nga operatorët ekonomikë, të cilët do të ekzekutojnë kontratën që po prokurohet. Një operator ekonomik i certifikuar sipas këtij standarti është në gjendje të:

*Krijojë kushtet më të mira të punës në të gjithë organizatën e tij;*

*Identifikojë kërcënimet dhe vendos kontrollin për menaxhimin e tyre;*

*Redukton aksidentet dhe sëmundjet në vendin e punës duke minimizuar kostot dhe kohën joproduktive;*

*Përfshin dhe motivon stafin me kushte më të mira dhe më të sigurta pune;*

*Dëshmon përputhshmëri ndaj klientëve dhe furnitorëve.*

Adresa: Rruga “Durrësit”, nr.132, Tiranë

Për të gjitha sa më sipër, kjo çertifikatë është kërkuar me qëllim garancinë e AK se ofertuesi ka potencialin e duhur për ushtrimin e veprimtarisë së tij, sa i takon të gjitha aspektetë të menaxhimit të riskut dhe të përputhshmërisë ligjore, dhe rrjedhimisht garanton AK mbi vazhdimësinë e marrëveshjes kuadër dhe zbatimin e kontratave që do të lidhen në kuadër të saj.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

### **SPECIFIKIME TEKNIKE PËR MATERIALE NDËRTIMI**

#### **1. Çimento**

Marka e Çimentos do të jetë 42.5 R: Çimento duhet të jetë colacen me rezistencë në shtypje 28 ditore  $\geq 42.5\text{N/mm}^2$ , në përputhje me SSHEN197-1që ka të bëjë me përbërjen, karakteristikat dhe kriteret e përputhshmërisë. Imtësia e bluarjes duhet të jetë jo më pak se 85%. Dendësia e çimentos duhet të jetë 3.05-3.15gr/cm<sup>3</sup>. Çimento do të jetë e ambalazhuar në thasë letre të pa dëmtuar 25 kg.

*Të paraqitet fletë analiza përkatëse për markën e kërkuar ditën e furnizimit të mallit.*

#### **2. Rërë e larë betoni**

Rërë e larë për beton: inertet (të imta) për të gjitha tipet e betonit duhet të përdoren duke respektuar STASH-512-78 (Standarti Shqiptar) ose në përputhje me ASTM C 33 "Inertet e betonit nga burime natyrale". Rëra duhet të jetë me madhësi të kokërrizave nga 1-5mm. Rëra duhet të jetë e pastër, të mos përmbajë grimca argjilore. Përmbajtja e grimcave të imta pluhurore që kalojnë nëpër sita më vrime 0.14mm lejohet deri në masën 20%. Rërat nuk duhet të përmbajnë lëndë të dëmshme si lëndë organike 0.5%, sulfate 1% dhe klorure 0.5%. Ato duhet të jenë të fortë dhe të qëndrueshëm dhe nuk duhet të përmbajnë materiale të dëmshme që veprojnë kundër fortësisë ose qëndrueshmërisë së betonit, ose në raste të betonarmesë mund të shkatërrojnë këtë përforcim. Materialet e përdorura si inerte, duhet të përftohen nga burimet e njohura për të arritur rezultatet e kënaqshme për klasat e ndryshme të betonit.

*Të paraqitet fletë analiza për rërën e larë nga laborator i Licensuar, ditën e furnizimit të mallit.*

#### **3. Çakell makinerie me përmasa të fraksionuar 5cm -7 cm**

Çakëlli duhet të plotësojnë kërkesat e STASH 539-87 "Për punime ndërtimi". Rezistenca në shtypje e shkëmbinjve nga të cilët prodhohet me copëtim mekanik çakëlli duhet të jetë jo më pak se 800kg/cm<sup>2</sup>. Nuk duhet të përmbajë mbi 10% grimca të dobëta dhe argjilore.

*Të paraqitet fletë analiza për çakëll të fraksionuar për indeksin e plasticitetit nga laborator i Licensuar, ditën e furnizimit të mallit.*

#### **4. Granil me përmasa 0.5mm-10 mm**

Granili mund të jetë gëlqeror ose lumi, duhet të plotësojë kërkesat e SSH EN 12620-2003. Rezistenca në shtypje e shkëmbinjve nga të cilët prodhohet me copëtim mekanik, granili duhet të jetë jo më pak se 800kg/cm<sup>2</sup>. Nuk duhet të përmbajë mbi 10% grimca të dobëta dhe argjilore.

*Të paraqitet fletë analiza për granilin nga laborator i Licensuar, ditën e furnizimit të mallit.*

Adresa: Rruga "Durrësit", nr.132, Tiranë

## **5. Gëlqere e pashuar**

Do të përdoret për dizifektim, do të jetë pluhur dhe do të jetë e ambalazhuar me thasë 50 kg. Duhet të ketë përqindje lagështie në tregues optimal.

*Të paraqitet fletë analiza për gëlqeren e pashuar nga laborator i Licensuar, ditën e furnizimit të mallit.*

## **6. Gëlqere e shuar**

Të ketë treguesit teknik sipas kërkesave në ndërtim. Të jetë i stazhionuar për jo më pak se 6 muaj. Të jetë e ambalazhuar në qese 10 kg dhe jo me përmbajtje të lartë uji.

*Të paraqitet fletë analiza për gëlqeren e shuar nga laborator i Licensuar, ditën e furnizimit të mallit.*

## **7. Hekur i zakonshëm Ø 6mm për beton**

Hekuri do të jetë Ø 6mm duhet të plotësojë kërkesat e SSH EN 15630-1. Hekur Sigma = 2400 Kg/ cm<sup>2</sup>. Hekuri i armimit duhet të jetë pa njolla, ndryshku, mbeturina të mullijve, bojra, vajra, graso, dhe rërave ngjitëse ose ndonjë material tjetër që mund të dëmtojë lidhjen midis betonit dhe armimit ose që mund të shkaktojë korrozion të armimit ose shpërberje të betonit.

*Furnizuesi duhet të paraqesë fletë analizën përkatëse nga Laboratore të Liçensuar, ditën e furnizimit të mallit.*

## **8. Dërrasë pishë e stazhionuar**

Dërrasa e pishës do të përdoret si armaturë gjatë betonimit të varreve provizorë të ketë përmasat 15cm x 4cm x 230cm dhe të jetë e mirë stazhionuar, e thate dhe pa nyje sipas standartit.

## **9. Bojë antiruxhio**

Boja antiruxhio do të jetë cilësi së parë. Boja të jetë e ambalazhuar në kuti metalike me masë 1 kg.

## **10. Bojë vaji zmalto për sipërfaqe metalike**

Bojë vaji zmalto do të jetë cilësi së parë. Tharja për prekje 2-3 orë në kushte atmosferike të përshtatshme. Ngjyra do të percaktohet nga investitori në momentin e lëvrimit të mallit. Boja të jetë e ambalazhuar në kuti metalike me masë 1 kg.

## **11. Penela 1.5 për lyerje gërma me bojë çimentato.**

Penela të jenë të cilësi e parë.

**Për mallrat çimento, boja antiruxho, boja e vajit zmalto duhet të jenë me fletë shoqëruese të skadimit. Afati i skadimit jo më pak se një vit nga data e furnizimit.**



**Argumentimi i specifikimeve teknike:** Specifikimet teknike, grafiku i lëvrimet për mallrat objekt prokurimi të secilit lot, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit, të cilat janë bashkëlidhur me dokumentet e tenderit. Ato përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

*Kujdes:* Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

*Shënim:* Në zbatim të nenit 26 pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

*Shënim:* Në mbështetje të nenit 88 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nëse kemi bashkim operatorësh ekonomikë, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

NR	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
1	Çiment M 42.5 R	ton	99
2	Rere e lare	m3	199.4
3	Granil 05inm-10 mm	m3	311.5
4	Cakull makinerie 5cm -7 cm	m3	500
5	Gelqere e shuar	kv	60

6	Gelqere e pa shuar	kv	70
7	Hekur Ø 6mni per beton	Ton	4.655
8	Derrase pishe e stazh 12cm x 4cm x 230cm	m3	2
9	Boje antiruxhio	kg	30
10	Boje vaji zmalto per siperfaqe metalike	kg	40
11	Penela 1.5	cope	40

Grafiku i lëvrimit hartuar nga specailisti i fushës dhe është si më poshtë vijon:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Çiment M 42.5 R	ton	99	19.95	19.95	59.1
2	Rere e lare	m <sup>3</sup>	199.4	40	40	119.4
3	Granil 05inm-10 mm	m <sup>3</sup>	311.5	63	63	185.5
4	Cakull makinerie 5cm -7 cm	m <sup>3</sup>	500	100	100	300
5	Gelqere e shuar	kv	60	10	15	35
6	Gelqere e pa shuar	kv	70	10	20	40
7	Hekur Ø 6mni per beton	Ton	4.655	0.9384	0.9384	2.7782
8	Derrase pishe e stazh 12cm x 4cm x 230cm	m3	2	2	0	0
9	Boje antiruxhio	kg	30	30	0	0
10	Boje vaji zmalto per siperfaqe metalike	kg	40	40	0	0
11	Penela 1.5	cope	40	40	0	0

**Afatet e lëvrimit:** Afati i lëvrimit fillon nga data e nënshkrimit të kontratës dhe përfundon më **31.12.2023**

#### **NJESIA E PROKURIMIT**

**Laureta Viluni**      **Personi përgjegjës për prokurimet** \_\_\_\_\_

**Zhaneta Shutina**      **Specialiste inxhinierë ndërtimi** \_\_\_\_\_

**Ensa Laci**      **Specialiste Finance e parë** \_\_\_\_\_